



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/12

Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/12
Datë: 05.02.2015

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit nr.04/L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Forcës së Sigurisë për dërgimin e Kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Republikën e Shqipërisë për operacion humanitar.
2. I rekomandohet Presidentes së Republikës së Kosovës për dhënien e Autorizimit për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe njoftimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.
2. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA 

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/12

Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ekzekutiv për shqyrtimin e mundësive për faljen e borxheve të personave fizik dhe juridik, ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike, në Republikën e Kosovës, deri me 31 dhjetor 2008 në këtë përbërje:
 - 1.1 Ministri i Financave, Kryesues;
 - 1.2 Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
 - 1.3 Ministri i Drejtësisë, anëtar;
 - 1.4 Ministri i Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 1.5 Ministri i Zhvillimit Ekonomik;
 - 1.6 Drejtori i Doganave të Kosovës, anëtar;
 - 1.7 Drejtori i Administratës Tatimore, anëtar;
 - 1.8 Drejtori i Zyrës Ligjore i Zyrës së Kryeministrit, anëtar dhe
 - 1.9 Drejtori i Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike.
2. Obligohen të gjitha institucionet të bashkëpunojnë me Komisionin dhe t'i përgjigjen kërkesave dhe ftesave të Komisionit.
3. Obligohet Komisioni që më së largu brenda një (1) muaji pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'i paraqes Qeverisë së Republikës së Kosovës rekomandimet e duhura lidhur me mundësitë e faljes së borxheve të personave fizik dhe juridik, ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike, në Republikën e Kosovës, deri me 31 dhjetor 2008.
4. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/12

Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 59 të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm në MZHE, Kryesues;
 - 1.2. Z. Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL, anëtar;
 - 1.3. Z. Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm në MF, anëtar;
 - 1.4. Z. Kapllan Halimi, Sekretar i Përgjithshëm në MBPZHR, anëtar dhe
 - 1.5. Z. Shkëlzen Sylja, Sekretar i Përgjithshëm në MFSK, anëtar;
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi që t'i kryej punët dhe detyrat në pajtim me Ligjin nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që brenda shtatë (7) ditësh të publikojë shpalljen për pozitat e lira në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/12

Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 paragrafi 1 të Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, dhe nenit 9. 10. dhe 11. të Rregullores Nr.03/2010 për përshkrimin e detyrave të punës, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Katalogu i vendeve të punës në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës aprovon ndryshimet dhe plotësimet në Katalogun e vendeve të punës për çdo vit buxhetor.
3. Autorizohet Ministria e Administratës publike të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Katalogut në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim të mbështetjes së institucioneve për përgatitjen e përshkrimeve të reja të vendeve të punës dhe ndryshimin e atyre ekzistuese, në përputhje me pikën 2. të këtij vendimi.
4. Obligohen të gjitha institucionet që kanë të punësuar nëpunës civil të zbatojnë Katalogun e vendeve të punës në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/12


Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafit 2. të nenit 7. të Ligjit Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ndryshimet në Tabelat 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale shumëvjeçare në bazë të paragrafit 2. të nenit 7. të këtij Ligji.
2. Obligohen ministrinë e ndikuara dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me Tabelat nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/12

Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194 si dhe paragrafin 2. të nenit 12. të Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Financave që të aprovoj transfere nga nën-programi-Shpenzimet e Paparashikuara në nën-program tjetër në Tabelat 3.1. dhe 4.1 për shumatat individuale të kërkuara deri në vlerë prej 20,000 (njëzetmijë) euro për vitin 2015 të ndarjeve buxhetore.
2. Shuma e totalit të këtij autorizimi nuk mund të kaloj 20% (njëzet për qind) të shumës së ndarë vjetore të nën-programit, Shpenzimet e paparashikuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/12

Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për ngritjen e nivelit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/12

Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr.07/133 të datës 05.06.2013

1. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 2. i Vendimit të Qeverisë Nr. 07/133 i datës 05.06.2013, me tekstin si në vijim:
2. Komisionin Qeveritar përbëhet nga:
 - 2.1. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Kryesues;
 - 2.2. Ministri i Financave, anëtar;
 - 2.3. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, anëtar;
 - 2.4. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar dhe
 - 2.5. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/12
Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës

1. Në Programin Legjislativ të vitit 2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihet:
 - 1.1. Projektligji për përgjimin e komunikimeve elektronike (MIE)
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/12
Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Dogana e Kosovës, që në bazë të nenit 9 paragrafit 1. të Kodit të Doganave dhe Akcizës Nr. 03/L-109, të lejojë importin e lodrave, duke u bazuar në dokumentin e konformitetit të lëshuar nga prodhuesi në vendin e prodhimit.
2. Obligohet Dogana e Kosovës që t'i kryejë obligimet nga paragrafi 1. i këtij vendimi, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, si dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Doganave dhe Akcizës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/12

Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e shtatë vjetorit të Pavarësisë në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar dhe
 - 1.5. Përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit, anëtar;
2. Ftohen që ta dërgojnë nga një përfaqësues në këshill:
 - 2.1. Përfaqësues, Zyra e Presidentes, anëtar;
 - 2.2. Përfaqësues, Kuvendi, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues, Komuna e Prishtinës, anëtar;
 - 2.4. Kryetarët e Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.5. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, anëtar dhe
 - 2.6. Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Për punën e Këshillit Organizativ për shënimin e shtatë vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës ndahen mjete financiare në vlerë prej 50,000 (pesëdhjetëmijë) euro.
4. Mjetet nga pika 3. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në Zyrën e Kryeministrit në kodin 10700.
5. Obligohet Ministra e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Këshilli për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/12
Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për Manifestimin gjithë-popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila do të organizohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa më 5, 6 dhe 7 mars në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kryesues;
 - 1.2. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Komuna e Skenderajt, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme, anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar.
2. Ftohen që ta dërgojnë nga një përfaqësues në këshill:
 - 2.1 Zyra e Presidentes, anëtar;
 - 2.2 Kuvendi, anëtar;
 - 2.3 Komuna e Prishtinës, anëtar;
 - 2.4 Organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.5 Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar dhe
 - 2.6 Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Për punën e Këshillit Organizativ ndahen mjete financiare në vlerë prej 50,000 (pesëdhjetëmijë) euro të cilat do të shfrytëzohen sipas nevojës për manifestim.
4. Mjetet financiare nga pika 3. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në kodin nr. 10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Zyrën e Kryeministrit.

5. Obligohet Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Këshilli për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë